

Proçesverbal

Sot në datë 16.11.2017 u mbajt dëgjese publike në ambjentet e Njesisë Administrative nr.6 me tematike “Buxheti për vitin 2018 për Njesisë Administrative nr.6, Bashkia Tiranë”. Në këtë takim ishin të pranishëm : Adminitratori i Njesisë Administrative nr.6 **z.Adriatik Merko**, i pranishëm ishte dhe **z.Erind Bejko**, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile dhe gjithashtu ishte **z.Ylli Çano** Anëtar Këshilli Bashkiak për Njesisë nr.6, ndërlidhësit për komunitetin, punonjës të ujesjellësit si dhe qytetarë nga kjo njësi.

Programi i këtij takimi:

Z.Adriatik Merko, Administrator i Njesisë Administrative nr.6, pasi falenderoi pjesëmarrësit përmëndi edhe investimet që aktualisht po bëhen dhe janë bërë në këtë njësi:

- Rikonstruksionin e Infrastrukturës Rrugore të Bllokut të kufizuar nga rrugët "Konferenca e Pezes" ,"Tre Dëshmorët" dhe rruga "Ali Jegeni""",
- Rikualifikimin Urban të Bllokut të kufizuar nga rrugët "Llambi Bonata", rruga "Haki Stërmilli", rruga "Musine Kokalari" dhe rikonstruksionin e rrugës "Zyber Zeneli" vazhdimi i rrugës "Ali Kelmendi",
- Shkolla e re “Betim Muço”.

Falenderimi gjithashtu shkon për Ndërmarrjen e Ujësjetllës - Kanalizimeve për punën e bërë për lidhjen e kontratave të ujit në zonat informale dhe kanalizimet.

Falenderim edhe për Drejtorinë nr. 2 të Bashkisë Tiranë për ndriçimin e territorit të Njesisë të cilën e gjeti në masën 30 % dhe tani funksionon në masën 90%.

Kërkesat për vitin e ardhshëm janë:

- 1- Të bëhet rikualifikim urban i zonës së SMT që kufizohet nga rrugët “ Leka i Madh”, “Sabaudin Gabrani” deri te rruga” Hamdi Cullhaj”.
- 2- Studimi dhe planifikimi urban i zonës informale me vendodhje në kodrat e Selitës, e cila përshkruhet ndërmjet rrugëve “Sabaudin Gabrani - Vasfi Samini – Jonuz Rama”.
- 3- Rikualifikim Urban i bllokut te banimit “Mehmet Shpendi – Thoma Koxhaj - Shaban Hysa - Dionis Filozofi – Bubulina”.
- 4- Hapësirat publike ndërmjet pallateve “ Blloku i pupuliteve” dhe Zona e pallateve 12-13 të rrugës “ Llambi Bonata”.
- 5- Rikonstruksionin e Infrastrukturës Rrugore në Zonën e ish Kombinatit Tekstil.
- 6- Ndërhyrje tek rezervuari i Vaqarrit (vazhdim i rrugës “Hamdi Cenojmeri”) si ambjent shplohës për komunitetin nëpërmjet APR-s.
- 7- Vendosija e bustit për veteranët në zonën e “Misto Mames”.

Z. Erind Bejko, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile

Bashkë me falenderimet për pjesëmarrjen Z. Bejko përmëndi investimet që janë bërë nga Bashkia Tirane. Parashikimet për vitin e ardhshëm do ruajnë të njëjtën vlerë si viti që lam pas.

Nga z. Bejko u përmëndën këto investime për vitin 2018:

- 1- Blloku “Sabaudin Gabrani - Vasfi Samini – Jonuz Rama”.
- 2- Projekt Austriak për të konfiguruar Qendrën e Kombinatit.
- 3- Rikonstruksion i tregut të përzier, ndërtim i tregut 2 katësh.
- 4- Rikonstruksioni i Kopshtit nr.34.
- 5- Rehabilitimi i zonës informale të kufizuar nga rrugët “Fabrika e Qelqit”, “Jorgo Panajoti”, “Besim Alla”.
- 6- Rikualifikim Urban për rrugët në Zonën e ish Kombinatit Tekstil.
- 7- Diskutim për zonën e Astirit.

Diskutimet vazhduan në formë bashkëbisedimi midis qytetarëve si përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë

Qytetari I (Zona “Misto Mame”) – Problem për ujësjellësin për mbi faturimet e larta (afrofe) për të cilat nuk kanë dijeni qytetarët, pasi i janë hapur vet kontratat nga faturistët.

Qytetari II (Zona “Misto Mame”) – Kemi problem 5 rrugica për kanalizet e ujërave të bardha dhe të zeza që nuk janë përfshirë në projektin e Rikonstruksionit e Infrastrukturës Rrugore të Bllokut të Misto Mames.

Qytetari III (Zona e pallateve “Çabej”) – Kemi problem në infrastrukturën rrugore dhe mungesë në çerdhe e kopshte për këtë zonë.

Z. Bejko – Studimi për të bërë një çerdhe dhe kopsht fillon në muajin mars të vitit të ardhshëm, në fundin e rrugës “Besim Alla”.

Qytetari IV (Shkolla “Myslym Keta”) – Kjo shkollë furnizohet nga 4 shkolla 9-vjeçare, ka shumë kapacitet në numër nxënësish. Kërkojmë ngritjen e një kati.

Z. Bejko - Zgjidhja nuk është shtesa, do fillohet ndërtimi i shkollave të reja, në zonen e Astirit dhe në rrugën “Tre Dëshmorët”.

Qytetari V (Rruga “Shaban Bardhoshi”) – Mbyllja e kanalit të hapur në pjesën fundore të rrugës “Shaban Bardhoshi”, që prej vitesh është problem shqetësues, në sezonin e verës rrezikohemi nga epidemit.

Z. Bejko - Për momentin nuk është parashikuar projekt, iu la detyrë ujësjellës kanalizime për zgjidhjen e problemit.

Qytetari VI (Rruga “Shaban Bardhoshi”) - Problem shqetësues ujërat e zeza nga firma e impiantit, si dhe uji i pijshëm nuk vjen në pjesën fundore të rrugës “Shaban Bardhoshi”.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!